



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 18, datë 23.10.2019

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

“KOMPLEKS TURISTIK PRIMERA” ME VENDNDODHJE NË BASHKINË SARANDË

Në mbështetje të neneve 7, shkronja “ç”, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Znj. Karolina Janina, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Kompleks Turistik PRIMERA”, me vendndodhje në Bashkinë Sarandë, me zhvillues Znj. Karolina Janina.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit, do t’i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Sarandë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

 **BLENDI KLOSI**



 **ANËTAR / SEKRETAR I KKT**

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

